



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 03/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____, si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i autorizuar të palës ankuese z. _____, av. _____, sipas autorizimit, si dhe përmbaruesit privat z. _____ dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 10.03.2022, me shumicë votash, mori si në vijim:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat, z. _____ i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2, të LPK-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesi privat, z. _____ i shqiptohet masa disiplinore "vërejtje" e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.1, të LPK-së.

A R S Y E T I M

Me datën 28.01.2022, përkatësisht me dt 01.02.2022, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____ i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në _____. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat z. _____ me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore P. nr 59/2017 ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke zbatuar procedurën përmbarimore pa njoftuar gjitha palët debitore lidhur me veprimet e ndërmarra. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat z. _____ ka caktuar

ankandin e shitjes së paluajtshmërisë për lëndën nr 59/2017 dhe i njëjti thirrjen me datën 29.10.2021 për pjesëmarrje në ankand e ka dorëzuar në emër të gjithë debitorëve me një fletë personale për të gjithë palët debitore në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, lidhur me nenin 110 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Duke u nisur nga kjo situatë, pala ankuese pretendon që veprimet e ndërmarra nga ana e përbaruesi privat z. [Blank], janë në kundërshtim me dispozitat ligjore për shkak që si rezultat i mos dorëzimit të shkresave, palëve të caktuara debitore i janë shkelur të drejtat e ushtrimit të mjeteve juridike në procedurën përbarimore. Rrjedhimisht, pala ankuese propozon Komisionit Disiplinor që konform dispozitave të LPP-së, të njëjtit t'i shqiptohet masa disiplinore - gjoba dhe vërejtje publike.

Me datën 08.02.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përbaruesit private z. [Blank] si organ përbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [Blank] lidhur me veprimet e ndërmarra nga përbaruesi privat në lëndën përbarimore P. nr 59/2019.

Përbaruesi privat z. [Blank] në përgjigjen e tij me shkrim thekson se me datën 10.09.2021 kishte shpallur ankandin e dytë të përsëritur me datën 14.10.2021. Përbaruesi privat z. [Blank] e pohon se është e vërtetë pretendimi i palës ankuese se konkluzionin e ankandit ua ka dërguar gjitha palëve debitore me një fletë dërgesë e jo secilit nga palët debitore veç e veç. Bazuar në vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas përbaruesit privat z. [Blank] me datën 07.10.2021, ishte emëruar zëvendës përbaruesi z. [Blank] për të proceduar më lëndët përbarimore të tij. Përbaruesi privat z. [Blank] thekson se ankandi ishte shtyrë me datën 25.10.2021 për arsye objektive dhe pastaj ishte shtyrë përsëri për datën 19.11.2021. Me datën 19.11.2021 zëvendës përbaruesi privat z. [Blank] kishte filluar seancën e ankandit por pasi që kishte konstatuar se konkluzioni i datës 25.10.2017 nuk i ishte dorëzuar gjitha palëve debitore, nuk plotësoheshin kushtet ligjore për vazhdimin e seancës dhe kishte vendosur në shtyrjen e seancës në afat të pacaktuar. Rrjedhimisht, sipas përbaruesit privat z. [Blank], meqenëse nuk kishte pasoja në dëm të palës ankuese, përkundër që në rastin konkret nuk ishin ndjekur plotësisht procedurat ligjore të dorëzimit të shkresave, kërkon nga ana e Komisionit Disiplinor të refuzon ankesën.

Me datën 10.03.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, përfaqësuesi i autorizuar I palës ankuese z. [Blank], av. [Blank], sipas autorizimit, si dhe përbaruesit privat z. [Blank].

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha ka bërë shtjellimin e Raportit Përfundimtar duke theksuar se mbetet pranë tij. Përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese z. [Blank], av. [Blank], si dhe përbaruesi privat z. [Blank] gjithashtu kanë paraqitur pretendimet e tyre lidhur me shkeljet e supozuara.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat z. [Emri i personit] ka kryer shkelje disiplinore.

Për sa i përket dërgimit të shkesave, neni 18 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcakton që *“Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të parapara për dërgimin e shkresave, vlejné edhe për aktvendimin për përmbarimin, urdhrin për përmbarim, aktvendimin lidhur me prapësimin kundër aktvendimit për përmbarim dhe aktvendimit për gjobën me të holla.”* Kurse neni 110 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që *“Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjete i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t'i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar.”*

Në vlerësimin e Komisioni Disiplinor, dorëzimi i shkresave të lëndës gjitha palëve me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore, përmbajtja dispozitave ligjore dhe ndjekja në mënyrë strikte dispozitat ligjore procedural është tejet e rëndësishme në mënyrë që të sigurohet një proces i rregullt përmbarimor. Shmangia nga dispozitat e procedurës mund të shpie në cenimin e të drejtave jo vetëm të njëjës palë, siç është rasti këtu - të palës debitore duke mbajtur të njëjtën të pa njoftuar për veprimet e ndërmarra përmbarimore, por, në efekt, edhe të drejtat e vet palës kreditore duke dhënë i shkas anulimit të mundshëm të veprimeve të ndërmarra përmbarimore përmes mjeteve juridike. Rrjedhimisht, lëshimet e tilla të karakterit procedural efektivisht i pamundësojnë në mënyrë të paarsyeshme realizimin e të drejtave të palës kreditore duke shkaktuar zvarritje të zbatimit të procedurës përmbarimore. Në rastin konkret, përmbarimi është lejuar me urdhrin përmbarimor të datës 17.03.2017. Duke qenë se kanë kaluar vite dhe përmbarimi nuk është përfunduar, ishte tejet e rëndësishme që organi përmbarimor të sigurohej paraprakisht që procedurat ndiqeshin me rregull. Në këtë rast, Komisioni Disiplinor nuk gjen ndonjë arsye të vlefshme juridike që arsyeton veprimin e përmbaruesit privat z. [Emri i personit] i cili kishte dërguar konkluzionin e datës 25.10.2017 për seancën e ankandit vetëm njërit nga palët debitore z. [Emri i personit].

[Emri i personit] e jo gjithë palëve kreditore siç kërkohet mbi bazën e dispozitave ligjore. Duke qenë se palët debitore janë vëllezër, përkatësisht familjarë, banojnë në të njëjtit fshat dhe ishin të përfshirë në të njëjtën procedurë ligjore, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, mundësitë që ndonjëri nga ta mos të ishte i njoftuar lidhur me veprimet e ndërmarra përmbarimore në rastin konkret janë minimale. Megjithatë, siç vërtetohet nga provat materiale, përkatësisht ftesë dërgesa personale, për pjesëmarrje në ankand e datës 29.10.2021, në rastin konkret, i ishte dorëzuar vetëm njërit nga palët debitore z. [Emri i personit] dhe jo secilës palë debitore veç e veç. Rrjedhimisht, edhe nëse të gjithë palët debitore ishin të njoftuar saktësisht me çdo veprim, kjo është e pamundur të faktohet objektivisht. Prandaj, në mungesë të provave materiale që secili nga palët debitore ishte i njoftuar në mënyrë të rregullt me seancat e ankandit, në rastin konkret, veprimet e ndërmarra nga ana e përmbaruesit privat z. [Emri i personit] ishin në kundërshtim me dispozitat ligjore. Edhe vet [Emri i personit] në seancën dëgjimore para Komisionit Disiplinor pohon se *“në procedurë sipas mjetit juridik, veprimet e ndërmarra nga ana e tij në këtë rast do të anuloheshin nga gjykata.”* Komisioni Disiplinor vlerëson se ky lëshim nuk është një lëshim i karakterit thjesht teknik. Si pasojë e mos dorëzimit të konkluzionit të gjithë debitorëve, zëvendës përmbaruesi privat

z. [redacted], në seancën dt 19.11.2021, kishte gjetur se nuk plotësohet kushtet ligjore të vazhdohet me ankandin e shitjes, rrjedhimisht, i njëjti kishte shtyrë seancën në afat të pacaktuar. Edhe pse pala debitore, këtu pala ankuese, nuk ka pësuar ndonjë dëm material, pasojat veprime e ndërmarra nga ana e përmbartuesit privat z. [redacted], subjekt i procedurës disiplinore duke mos dorëzuar konkluzionin në fjalë të gjitha palëve debitore pashmangshëm kanë ndikuar negativisht procedurën përmbartimore dhe të drejtat e palëve në procedurë duke shkaktuar zvarritje pa ndonjë arsye të vlefshme.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor kishte parasysh gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin se pala ankuese nuk kishte pësuar ndonjë dëm. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbartuesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbartuesin privat si dhe tek përmbartuesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbartimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 03/2022, datë 10.03.2022



Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.